



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Stilistikë

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore; 4 kredite; (20 leksione, 20 seminare)

Viti / Semestri: Viti III, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

Kodi i etikës :Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: synon të njohë studentët me gjuhën e sotme letrare greke, llojet e stileve të përdorura në gjuhën letrare, me njësitë dhe nocionet fillestare, stilemën, përftesat, ngjyrimet stilistike, normën stilistike, shprehësinë, organizimin stilistik të tekstit, tipat e ligjërimit, kategoritë e teksteve, parimin drejtues, fono-stilistikën, morfo-stilistikën, sintakso-stilistikën, leksiko-stilistikën dhe fjalëformimin, shtresimin sipas normës, huazimet, neologjizmat, frazeologjinë, semanto-stilistikën, antoniminë, sinoniminë, kuptimet, lidhjet e reja të fjalëve dhe figurat, fushën tematike, ligjërimit dhe stilet funksionale, ligjërimit e folura, ligjërimit e shkruar, leksikun e fushës, letërsinë dhe gjuhën letrare, pragmatikën, nocionet themelore dhe parimet e pragmatikës.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Studentët do të njohin elemente të fono-stilistikës, morfo-stilistikës, sintakso-stilistikës, leksiko-stilistikës;
- 2.Të njohë fjalëformimin në gjuhën greke dhe shtresimin sipas normës;
- 3.Të njohë frazeologjinë e gjuhës greke; të kuptojë semanto-stilistikën e gjuhës greke lidhjet e reja të fjalëve dhe figurat, fushën tematike;
- 4.Të dallojë ligjërimit dhe stilet funksionale; të përgatisë një detyrë kursi bazuar në njohuritë e marra në këtë lëndë.